



# NJOFTIM PËR KONTRATË

## *Furnizim Procedure për kuotim çmimesh*

*Në përputhje me Nenin 13 të "Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës" (Dhjetor 2024)*

Data: 06.12.2024

Nr. i Prokurimit: BQK 24 083 134

### I EMRI DHE ADRESA

Emri zyrtar: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	
Adresa: Rr. Garibaldi 33, 10000 Prishtinë	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Kontakt: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-mail: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763

### II LËNDA E KONTRATËS

#### II.1 PËRSHKRIMI

Titulli i kontratës: "Furnizim me material zyrtar për stafin me rastin e shënimit të 25-vjetorit të BQK-së"
Lloji i prokurimit: Furnizim
Vendi kryesor i realizimit: BQK
Informacione të marrëveshje afatgjatë (nëse aplikohen): Jo
Variantet pranohen: Jo
Vlera e parashikuar e kontratës: 6,500.00 euro
Ndarja në Pjesë: JO

### III INFORMACIONE PËR FURNIZIMIN

Qëllimi i kësaj kontratë është të përzgjedhet kontraktuesi i cili do të realizoj në mënyrë profesionale furnizimet duke përfshirë printimin dhe prodhimin e materialeve sipas karakteristikave teknike dhe funksionale të përshkruara në dosjen e këtij tenderi. Për më tepër informata rreth specifikimeve teknike, ofertuesit e interesuar do të njoftohen përmes Dosjes së Tenderit e cila do t'u shpërndahet në bazë kërkesave që vijnë prej tyre.

#### IV KRITERET E PËRZGJEDHJES<sup>1</sup>/KUSHTET E OBLIGUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjitha kompanitë (operatorët ekonomik) e interesuara janë të obliguara që t'i dorëzojnë së bashku me tenderët e tyre dokumentet për përshtatshmëri siç kërkohet këtu në vijim:

<p>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik – <i>Kjo kategori e dokumenteve (kërkesat 1, 2 (dhe 3 në rast se aplikohet)) është e obligueshme në dorëzim me ofertë dhe se nuk mund të plotësohet dhe/ose sqarohet pas dorëzimit të ofertës!</i></p>	<p><b><u>Kërkesa 1:</u></b> Deklarata nën betim se ofertuesi përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë.</p>
	<p><b><u>Evidenca 1:</u></b> Deklaratë nën betim e plotësuar dhe nënshkruar duke përdorur formën në “Aneksin 3” të dosjes së tenderit.</p>
	<p><b><u>Kërkesa 2:</u></b> Formulari i tenderit në formën standarde siç gjendet në Dosjen e tenderit, Pjesa C, përfshirë “Deklaratën e ofertuesve”</p>
	<p><b><u>Evidenca 2:</u></b> Formulari i tenderit duhet të plotësohet me informatat siç kërkohen në formular (identifikimi i ofertuesit, çmimi me numra dhe fjalë, periudha e vlefshmërisë së ofertës, etj.) dhe duhet të nënshkruhet dhe vuloset.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/konzorcium, të gjithë anëtarët e grupit duhet të sigurojnë dëshmi mbi pranueshmërinë e tyre sipas kërkesave të listuara në pikat 1, 2 dhe 3.</p>
	<p><b><u>Kërkesa 3:</u></b> Marrëveshja mbi krijimin e grupit/konzorciumit (Kjo kërkesë aplikohet vetëm në rast se oferta dorëzohet nga një grup/konzorcium)</p>
	<p><b><u>Evidenca 3:</u></b> Nëse një tender dorëzohet nga një grup i ofertuesve, nga grupi kërkohet që së bashku me tenderin të dorëzojnë edhe marrëveshjen e nënshkruar në origjinal për krijimin e grupit. Të gjithë anëtarët e grupit në fjalë janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm para ofertuesit për përmbajtjen e tenderit të grupit dhe nëse kontrata përkatëse i ipet grupit në fjalë, ata gjithashtu janë së bashku dhe veçmas të përgjegjshëm për ekzekutimin e kontratës në fjalë. Në marrëveshjen e grupit kërkohet të specifikohet lideri i grupit.</p>

<sup>1</sup> Sipas nenit 32 të Rregullës për prokurimin në BQK “Kriteret e përzgjedhjes”

<p><i>Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve (kërkesat 4, 5 dhe 6) mund të kërkohen dokumentacion plotësues ose sqarime</i></p>	<p><b><u>Kërkesa 4:</u></b> Dëshmi nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se ofertuesi në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Evidenca 4:</u></b> Një vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë në pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p> <p><b><u>Kërkesa 5:</u></b> Regjistrimi si ofertues në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin e juaj të themelimit.</p> <p><b><u>Evidenca 5:</u></b> Kopja e certifikatës së regjistrimit me informatat mbi biznesin.</p> <p><b><u>Kërkesa 6:</u></b> Dëshmi se kompania nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata.</p> <p><b><u>Evidenca 6:</u></b> Vërtetim nga Gjykata për Çështje Ekonomike i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.</p>
	<p>Në rast se tenderi dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik/ konzorcium, të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave 4, 5 dhe 6.</p>
<p><i>Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare</i></p>	<p>Nuk aplikohen</p>
<p><i>Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale – Për këtë kategori të dokumenteve</i></p>	<p><b><u>Kërkesa 7:</u></b> Ofertuesit duhet të dorëzojnë Mostrat e kualitetit të lartë, sipas tabelës tek specifika teknike, për secilin artikull të kërkuar.</p> <p><b><u>Evidenca 7:</u></b> Të dorëzohen mostrat e të gjithë artikujve</p>

## V PROCEDURA

### V.1 Lloji i procedurës: Procedure për Kuotim çmimesh

VI. KRITERET PËR DHËNIEN E KONTRATËS: “Tenderi ekonomikisht më i favorshëm” në përputhje me nenin 34 të Rregullës së prokurimit në BQK

#### VI.1 Kriteret:

Kriteri	Pesha
1. Çmimi	60%
2. Mostrat sipas kualitetit	40%

## VII. INFORMATA ADMINISTRATIVE

Kushtet për marrjen e dosjes se tenderit: Afati i fundit për kërkesë për dosjen e tenderit: 11.12.2024, ora 12:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a> .
Afati i fundit për të paraqitur kërkesë nga ofertuesit për sqarime shtesë: 11.12.2024, ora 12:00 në e-mail adresën: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a> .
Dokumentet me pagesë: Jo
Kushti i sigurimit të tenderit (ofertës): n/a
Kushti i sigurimi të kontratës: n/a
Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 60 ditë nga data e dorëzimit respektivisht e hapjes
Afati i fundit i dorëzimit të ofertave: 12.12.2024, ora 14:00; në objektin e BQK-së, Zyra e Arkivit, rr. “Garibaldi” nr. 33, Prishtinë.
Takimi për hapjen e ofertave: 12.12.2024, ora 14:30, Objekti i BQK-së, rr. “Garibaldi” nr.33, Prishtinë.

## VIII. ANKESAT

Në përputhje me “Rregullën e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Dhjetor 2024)”, respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr Garibaldi 33, 10000 Prishtinë, [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org), brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivën e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e

parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

#### IX. ADRESA

Rr. Garibaldi 33	
Qyteti: Prishtinë	Kodi postar: 10000
URL (nëse aplikohet): <a href="http://www.bqk-kos.org">www.bqk-kos.org</a>	
Personi kontaktues: Divizioni i prokurimit dhe kontraktimit	E-maili: <a href="mailto:prokurimi@bqk-kos.org">prokurimi@bqk-kos.org</a>
Telefoni: 038 222 055/452	Fax: 038 243 763